



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Kaçanikut**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipal Kaçanik**

**01Nr. 60/01-23935/24**  
**Kaçanik, 25.09.2024**

## **PROCESVERBAL**

Nga mbledhja **VII (Shtatë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 25 shtator 2024 (e Mërkurë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në zyrën e kryetarit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri – Çaka - PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK. Mungoj Arben Thaqi - OJQ.

Në takim mori pjesë Halim Shehu – Komandant i stacionit policor në komunën e Kaçanikut.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Proce mbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

**z.Ekrem Livoreka:** Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e VII -të (shtatë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2024, data 25 shtator, me këtë :

### **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

### **APROVOJ**

**Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

**Kryesuesi i Komitetit, Ekrem Livoreka:** A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, a jeni për miratimin e këtij procesverbalit?

Procesverbalit i mbledhjes së VI (gjashtë) të Komitetit për Komunitete për vitin 2024 u miratua njëzëri. Në saje të kësaj, konstatimi është se Komiteti për Komunitete.

**Aprovoj**  
**Procesverbalin e mbledhjes se VI (gjashtë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2024, të datës 19.06.2024 / Lënda : 01Nr. 60/01-14117/24.**

**2. Gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut:**

**z.Halim Shehu:** Z. Halim Shehu: Gjithsej, në periudhën kohore Korrik – Shtator janë raportuar 102 raste. Prej tyre, veprat penale janë si në vijim:

- Vjedhje: 12 raste
- Vjedhje e rëndë: 3 raste
- Vjedhje e pyllit: 1 rast
- Dhunë në familje: 4 raste
- Ngacmim: 5 raste
- Ngacmim seksual: 1 rast
- Falsifikim i parasë: 2 raste
- Falsifikim i dokumenteve: 2 raste
- Lëndim i lehtë trupor: 6 raste
- Blerje, posedim, shpërndarja dhe shitja e narkotikëve: 3 raste
- Asgjësim apo dëmtim ose heqja e instalimeve publike: 3 raste
- Asgjësim apo dëmtim i pasurisë: 3 raste
- Kanosje: 10 raste
- Kanosje ndaj personit zyrtar: 2 raste
- Sulm: 2 raste
- Sulm ndaj personit zyrtar: 2 raste
- Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedimi i paautorizuar i armëve: 5 raste

Këto janë të dhënat e raportuara për periudhën përkatëse.

**Znj.Arta Avdiu:** Dëshiroj të ndërlihem me diçka. Siç dihet, jemi në muajin Shtator, i cili na kujton fillimin e vitit shkollor. Ky fillim i vitit shkollor nisi me një shqetësim që na ka tronditur, si mua si nënë, por besoj se edhe çdo qytetar të vendit tonë. Një akt i shëmtuar, që ka të bëjë me ngacmimin seksual, është raportuar nëpër shkollat tona, konkretisht në fshatin Dubrav, ku është denoncuar një rast i ngacmimit seksual ndaj një nxënëse nga një mësimdhënës. Situata të tilla janë mjaft të rënda dhe të pa tolerueshme. Andaj, do të doja të dija se ju si institucion, cilat janë hapat që keni ndërmarrë në këtë rast dhe sa jemi ne si komunë të rrezikuar nga kjo dukuri negative.

**z.Halim Shehu:** Kjo dukuri negative fillimisht duhet të lajmrohet nga prindërit, domethënë ata duhet të jenë më të kujdesshëm. Në rastin konkret që po flasim, personi është arrestuar dhe është mbajtur me urdhër prokurori. Tani është në arrest shtëpiak, por kjo nuk e liron nga përgjegjësia. Autoritetet kanë mbledhur prova të mjaftueshme, dhe nuk ka elemente për të mbajtur në paraburgim deri sa të dalë para gjykatës. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që edhe familjarët kanë heshtur për këtë çështje, sepse ai thotë se ka qenë nxënëse e tij për vit të tërë, që nga klasa e pestë, dhe ka pasur raporte të afërta me të, jo në kuptimin e ngacmimit seksual, por si fëmijë e ka përkëdhelur më tepër. Megjithatë, ka ardhur një moment kur kjo ka kaluar në vepër penale, dhe ndoshta asnjë prind nuk

duhet të krijojë për fëmijët e tyre raporte të tilla të afërta pa ditur kush është prindi dhe kush është mësuesi, pa marrë parasysh që ne gjithmonë e kemi llogaritur mësuesin si prind të dytë.

Përndryshe, shumica e shkollave kanë psikologë dhe kujdestarë të klasës, dhe nuk ka raste të tjera të raportuara për këtë qëllim. Në Kaçanik të Vjetër, kemi një rast me një nxënës i cili është me probleme mendore. Jemi duke punuar me këtë rast, dhe drejtori i drejtorisë për Arsimin, Zahir Doda, si dhe drejtori i shkollës në Kaçanik të Vjetër, janë të informuar.

**z.Ekrem Livoreka :** Kërkesa e parë vjen nga banorët e rrugës "Idriz Seferit", të cilët ankohen për dëmtimin e rrugës nga kamionët me peshë të rëndë. Me mbylljen e rrugës magjistrale, këta kamionë tani po qarkullojnë në këtë rrugë, e cila nuk është e përshtatshme për një ngarkesë të tillë. Sipas shenjave të komunikacionit, ata nuk e kanë të drejtë të qarkullojnë aty.

Do të dëshiroja që ndonjëherë të dilni dhe t'i tërhiqni vërejtjen, sepse kjo situatë po i rrezikon edhe automjetet e tjera, përfshirë autobusët, pasi rruga është shumë e ngushtë.

**z.Halim Shehu:** Ne jemi duke shqiptuar gjoba, por nuk jemi 24 orë në atë rrugë. Gjobat janë të mjaftueshme, megjithatë kam marrë ankesa lidhur me shqyrtimin e gjobave, sepse ata thonë se nuk u janë bërë rrugë alternative dhe se nuk e dinë se ku duhet të shkojnë.

**z.Ekrem Livoreka :** Kërkesa tjetër vjen nga qytetarët e komunës Kaçanikut, të cilët pyesin nëse kamerat e sigurisë janë funksionale.

**znj.Arta Avdiu :** Sa kohë që këto kamera nuk janë funksionale dhe nëse keni ngritur ndonjë shqetësim në lidhje me to.

**z.Halim Shehu:** Që një vit e diçka, kamerat e sigurisë nuk janë funksionale. Ne kemi ngritur shqetësimin, por kryetari i komunës nuk ka treguar gatishmëri për t'i siguruar ato. Ai thotë se nuk ka donacione dhe nuk është e paraparë, megjithatë, të gjitha komunat e tjera i kanë donacionet nga komunat e veta. Ne i menaxhojmë kamerat, por komuna është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe vendosjen e tyre.

**z.Ekrem Livoreka:** Unë në mbledhjen e KKS-së para tre muajsh, ti nuk ke qenë komandant prezent. Komandant, nuk e di nëse ti po ia hedh fajin komunës apo komuna ty, por një gjë e di: në kuvend e kam bërë këtë pyetje konkretisht drejtorit të shërbimeve publike. Ai më është përgjigjur se kompetencat për mirëmbajtjen e kamerave të sigurisë i ka vetëm stacioni policor. Këtë përgjigje ma ka kthyer mu.

Tani po të pyes ty, pasi je personi i parë që na informove se kamerat nuk funksionojnë. Një rast ka ndodhur para dy ditësh, ku një person e ka shkelur një tjetër me biçikletë, dhe nëse ai nuk ndalet, si do ta gjejmë? As ti nuk mundesh të dish se kush ka qenë, sepse shumica hezitojnë të tregojnë, duke ditur që informacionet dalin nga stacioni policor dhe se filani ka treguar.

**z.Halim Shehu:** A keni takime në nivel të Kosovës me komunat e tjera? Pyetni komunat e tjera kush e bën menaxhimin dhe kush e bën mirëmbajtjen. Ne ia kemi dërguar edhe një shkresë me shkrim, dhe kryetari na ka premtuar që do ta shqyrtojë mundësinë e gjetjes së një donacioni ligjor, që të mos mbajmë përgjegjësi para dikujt. Edhe pse komunat e tjera i kanë të gjitha sistemet e tyre, është problemi i tyre. Megjithatë, policia nuk blen kamera

për sigurinë e qytetarëve që të vendosen nëpër qytet; ne po e bëjmë këtë për stacionin tonë.

**z.Ekrem Livoreka:** Në fakt, kamerat janë të vendosura, por nuk funksionojnë.

**z.Halim Shehu:** Jo, kamerat janë të gjitha të çmontuara, ato janë dalë prej rrjetit gjatë punimeve në rrugë që keni bërë, do të thotë se i keni hequr.

**znj.Arta Avdiu:** Këto kamera, domethënë janë hequr nga komuna gjatë punimeve.

**z.Halim Shehu:** Kamerat nuk i ka hequr komuna, por i ka hequr shtyllat.

**z.Ekrem Livoreka:** Ju, pasi keni kompetencë, pse nuk e paditni komunën?

**z.Halim Shehu:** Çështja e sigurisë është përgjegjësi e komunës për të siguruar komitetin.

**z.Ekrem Livoreka:** Kur ndodh një aksident, vrasje, ose rrahje, mund të identifikohen përmes kamerave të sigurisë.

**z.Halim Shehu:** Ne në policinë kemi kamera dhe ndoshta do të vendosim edhe kamera të fshehta, por ato janë për interesa të natyrshme, për një rast ose një vepër, dhe jo për sigurinë e qytetit. Nuk ndodh në asnjë qytet të Kosovës që policia të blejë kamerat; ne i mbikëqyrim ato, por mirëmbajtjen e bëjnë kontraktuesit e komunës.

**znj.Arta Avdiu:** A keni bërë kërkesë te komuna?

**z.Halim Shehu:** Po, kemi bërë kërkesë. Që dy vite jemi duke debatuar për këtë çështje të kamerave të sigurisë.

**z.Ekrem Livoreka:** Kur i përmende rastet e narkotikëve, keni tre raste. Çfarë keni vepruar me ato persona dhe a i keni arrestuar?

**z.Halim Shehu:** Po, arrestohen dhe e njoftojmë prokurorin. Nëse është sasi e vogël, prokurori thotë të lëshojmë procedurën e rregullt dhe i dërgojmë fletëparaqitjen kur ta thërrasë prokurori.

**z.Ekrem Livoreka:** A paguajnë ndonjë gjobë?

**z.Halim Shehu:** Po, një gjobë e vogël, rreth 400 deri 500 €.

**z.Ekrem Livoreka:** Me këto gjoba të vogla, a mendohet se mund të ndalen këto veprime, apo vetëm i shtohen edhe më shumë? Sepse ata thonë unë e paguaj dhe prapë vazhdojnë.

**z.Halim Shehu:** Nëse është recidivist i merr për bazë prokurori për veprën tjetër dhe e ngrit me rrethana rënduese.

**znj.Arta Avdiu:** Nëse kapet përsëri i njëjti person.

**z.Halim Shehu:** Po domethënë prokurori merr rrethanë rënduese dhe e gjobit më shumë ose mundet me dërgua në mbajtje, zakonisht prej praktikave nuk shkon në burg asnjë.

**znj.Arta Avdiu:** Për mua, kjo dukuri duhet të ndalet. Mendoj se gjobat duhet të jenë shumë më të rrepta; përndryshe, nuk mund të parandalohen.

**z.Halim Shehu:** Ligji është miratuar në Kuvend, që do të thotë se policia nuk ka ndikim mbi ligj, por ligjvënësi ka dhënë mendimin e tij dhe e ka paraparë gjobën prej 50 deri 100€ dhe prej 400 deri 500€. Ajo duhet të shqiptohet; as prokurori nuk mund të dalë jashtë këtyre normave.

Tani, për vjedhjen e pyllit, kemi telashe. Prokurori thotë: 'A e ke zënë me fotografi, me motor në dorë?' Nëse nuk e ke dokumentuar, thotë se është pak problem. Si mund të largohet nga lisi? Transporti ilegal është 100 € gjobë, por ndoshta ai person ka të ngarkuar 500 € dru, ndërsa ne vetëm 100 € gjobë.

**z.Ekrem Livoreka:** A ka pasur prerje më pak këtë vit apo vitin e kaluar?

**z.Halim Shehu :** Thuajse afërsisht ka qenë njëjtë në këto dy vite.

**znj.Arta Avdiu:** Desha të lidhem me këtë: Ne jemi në muajin shtator dhe dihet që do të ketë reshje shiu. Çfarë masash merrni ju si institucion i sigurisë për të siguruar qytetarët në rast të ndonjë vërshimi?

**z.Halim Shehu:** Në rast vërshimi, ne kemi planet operative. Për pastrimin e rrugëve, kemi një kontratë, që do të thotë se komuna ka një marrëveshje me kompaninë e cila del edhe gjatë ditës dhe natës sa herë që kemi nevojë. Nuk ka ndodhur asnjëherë që të mos dalin. Kryesisht, bllokohen më shpesh rrugët në Ivajë dhe Kotlinë.

**znj.Arta Avdiu:** Do të thotë, nëse qytetarëve të komunës Kaçanikut iu ndodh një vërshim, ju jeni të gatshëm dhe komuna menaxhon mirë situatën.

**z.Halim Shehu:** Po, është departamenti i emergjencave, bashkë me policinë dhe qeverinë, që ka të parapara ato plane. Por shpresojmë të mos ndodhin.

**z.Ekremin Livoreka:** Sa është bashkëpunimi me drejtorët e shkollave dhe si është gjendja në terren?

**z.Halim Shehu:** Ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë me drejtorët e shkollave. Në çdo stacion policorë edhe në komunën e Kaçanikut e kemi një grup të zyrtarëve policorë që është i trajnuar për policinë në komunitet, të cilët mbajnë ligjëratat në çdo shkollë. Aktualisht jemi duke zhvilluar ligjëratat me klasat e para për çështje të sigurisë në rrugë dhe me katër tema tjera si: dhuna në familje, ngacmimet seksuale, abuzimet me droga dhe bulëzimi, të cilat tema ne i ligjërojmë d.m.th. policia shkojnë në çdo shkollë prej fillimit të vitit shkollor në muajin shtator e deri në përfundim të vitit shkollorë. Me gjithë drejtorët kemi raporte shumë të mira dhe kontakte edhe të rregullta mujore.

**z.Betim Shala:** Kur dikush akuzon, si në rastin e profesorit që ka ndodhur, a shkoni direkt e arrestoni, apo duhet të keni ndonjë provë për ta arrestuar? Sepse dikush mund ta thotë thjesht pa asnjë bazë.

**z.Halim Shehu:** Fillimisht, në momentin që dikush e akuzon një person si të dyshimtë, ai duhet të intervistohet nga policia. Pas intervistimit, do të mblidhen prova të tjera, si pamjet nga kamerat, dëshmitarët, viktima që deklarohen, si dhe çfarëdo dëshmish tjetër, si thirrjet telefonike, mesazhet, apo diçka tjetër.

**znj.Arta Avdiu:** Gjatë asaj periudhe, i akuzuari qëndron në paraburgim.

**z.Halim Shehu:** Prokurori vendos nëse e dërgon në paraburgim apo jo. Në momentin që ne i dërgojmë në stacion, e intervistojmë dhe e njoftojmë prokurorin menjëherë.

**znj.Arta Avdiu:** Dhuna në familje, siç e theksove edhe vet, janë katër raste. Desha të di sa shqetësuese janë këto raste dhe ku përfundojnë të dhunuarit në këtë rast?

**z.Halim Shehu:** Për dhunën në familje, prokurori nuk lëshon shumë, në fillim i dërgon në burg për 30 ditë. Të dhunuarit, nëse zgjedhin të mos kthehen në atë familje, mund të drejtohen në qendrën strehimore.

**znj.Arta Avdiu:** Sa kohë kanë të drejtë të qëndrojnë në qendrën strehimore?

**z.Halim Shehu:** Kanë të drejtë të qëndrojnë në qendrën strehimore për 6 muaj. Pas kësaj, fillojnë procedurat gjyqësore dhe ata mund të jetojnë në mënyrë private.

**znj.Arta Avdiu:** Në rast se nuk kanë kushte për të siguruar strehim privat, atëherë duhet të detyrohen të kthehen përsëri te dhunuesi.

**z.Halim Shehu:** Jo, nuk janë të detyruar të kthehen te dhunuesi, sepse ata mund të kenë familje ose të vendosin të jetojnë vetë. Shteti nuk mund t'i mbajë gjithë jetën.

**3.Të ndryshme:**

**Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka:** A keni diçka për të diskutuar në pikën e ndryshme? Nëse jo, atëherë e shpall mbledhjen të përfunduar në ora 12:08.

**Procesmbajtësja  
Mavije Murseli**



**Kryesues i Komitetit për Komunitete  
Ekrem Livoreka**

